



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

**RAPORT  
(Përfundimtar)**

**PËR**

**MBIKËQYRJEN E LIGJSHMËRISË GJATË ZHVILLIMIT TË PROCEDURAVE TË  
KONKURRIMIT PËR PLOTËSIMIN E POZICIONEVE TË LIRA NË SHËRBIMIN  
CIVIL**

**NJËSIA E VETËQEVERISJES VENDORE  
BASHKIA KORÇË**

**Tiranë, shkurt 2024**

## RAPORT

### **Për mbikëqyrjen e ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil në njësinë e vetëqeverisjes vendore, Bashkia Korçë**

#### **Hyrje**

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, në zbatim të planit vjetor të mbikëqyrjes dhe të vendimit nr. 89, datë 01.11.2023, “*Për kryerjen e mbikëqyrjes në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të plotësimit të pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimi në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, në Bashkinë Korçë*”, i ndryshuar, me vendimin nr. 93, datë 17.11.2023, të Komisionerit, ka filluar mbikëqyrjen në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil, nëpërmjet pranimi në shërbimin civil; lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, nga ana e subjekteve të ngarkuara prej ligjit me detyra specifike për administrimin e këtij procesi.

Mënyra e funksionimit të njësive të vetëqeverisjes vendore, kompetencat, të drejtat dhe detyrat e tyre e të organeve përkatëse, janë të rregulluara me ligjin nr. 139/2015 “*Për vetëqeverisjen vendore*”. Sipas këtij ligji, njësitë e vetëqeverisjes vendore, janë bashkitë dhe qarqet, të cilat realizojnë vetëqeverisjen vendore në Republikën e Shqipërisë.

Në nenin 6 dhe 65 të këtij ligji, përcaktohet se: “*Bashkia përbëhet nga disa njësi administrative, sipas lidhjeve tradicionale, historike, ekonomike dhe sociale. Njësitë administrative në territorin e një bashkie, shtrirja e tyre territoriale dhe emri, përcaktohen me ligj*”;

“*Struktura dhe organika e administratës së njësive administrative janë pjesë të strukturës dhe organikës së administratës së bashkisë*”.

Në rastin konkret, Bashkia Korçë ka në përbërje të saj njësitë administrative Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Vokopjë, Voskop, Vithkuq dhe Lekas, të përcaktuar në ligjin nr. 115/2014 “*Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë*”. Struktura dhe organika e këtyre njësive administrative, janë pjesë përbërëse e strukturës dhe organikës së administratës së Bashkisë Korçë, e në këto rrethana, kryerja e mbikëqyrjes është shtrirë edhe në njësitë administrative.

Administrimi i të dhënave dhe grumbullimi i dokumentacionit në subjekt u realizua sipas Programit të Mbikëqyrjes nr. 1057/1, datë 01.11.2023, të miratuar nga Komisioneri, njoftuar

Kryetari të Bashkisë Korçë me shkresën nr. 1057/2, datë 01.11.2023, “*Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes së ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në Bashkinë Korçë*”. Mbi bazën e këtyre akteve, grupi i punës u paraqit në subjektin e mbikëqyrjes në datën 20.11.2023.

Objekti i mbikëqyrjes përfshin kontrollin dhe vlerësimin e zbatimit të ligjshmërisë gjatë realizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm në institucion, grupi i punës, i përbërë nga inspektorët Zamira Mujali dhe Dorela Halilaj, nën drejtimin e Drejtorit të Inspektimit dhe Hetimit Administrativ Luiseda Zhapa, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në institucionin Bashkia Korçë.

Me shkresën nr. 25 prot., datë 08.01.2024 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje institucionit të mbikëqyrur, duke i lënë 5 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Institucioni i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të mbikëqyrjes me shkresën e tyre nr. 8816/3 prot., datë 12.1.2024 “*Kthim përgjigje*” (protokolluar në KMSHC me nr. 25/1, dt. 22.1.2024), ka dërguar të nënshkruar projektraportin, pa vërejtje, i cili është administruar në dosjen e mbikëqyrjes.

Në këto rrethana, duke u konsideruar e plotësuar kërkesa për zbatimin e procedurës në këtë rast, u hartua edhe raporti përfundimtar i mbikëqyrjes

### **Qëllimi i mbikëqyrjes:**

- Monitorimi, kontrolli dhe vlerësimi i zbatimit të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore të dala në bazë e për zbatim të tij.
- Paraqitja para përgjegjësve për administrimin e shërbimit civil, njësisë së burimeve njerëzore dhe titullarit të institucionit, e konstatimeve dhe fakteve të evidentuara dhe të vlerësuara si parregullsi në lidhje me zbatimin e ligjit për nëpunësin civil.
- Paralajmërimin e institucionit dhe lënien e detyrave për përmirësimin e situatës, brenda një afati të arsyeshëm, sipas përcaktimeve të bëra në nenin 15, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar.

## **DREJTIMET E MBIKËQYRJES:**

Mbikëqyrja do të orientohet drejt verifikimit të situatës së administrimit të shërbimit civil në këtë institucion, për të arritur në konkluzion se si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, në lidhje me respektimin e skemës së administrimit të shërbimit civil, si dhe të procedurave që ndiqen gjatë aplikimit të instituteve të ligjit.

1. Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
2. Procedura e ndjekur nga institucioni në lidhje me miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil.
3. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22 dhe akteve nënligjore në lidhje me dy fazat e këtij procesi:
  - verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse, nëse konkurrentët i plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të vendit të punës;
  - vlerësimi i kandidatëve nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit.
4. Emërimet në shërbimin civil pas përfundimit të procesit të konkurrimit dhe menaxhimi i listës së kandidatëve fitues që kanë arritur pikët, por që nuk janë emëruar. Evidentimi i rasteve të emërimit pa konkurrim, në kundërshtim me kërkesat e nenit 23, të ligjit për nëpunësin civil.
5. Respektimi i kërkesave specifike ligjore, gjatë procesit të përmbushjes së periudhës së provës (*si janë zbatuar detyrimet e nëpunësit dhe eprorit si dhe procedura e vendimmarrjes në përfundim të kësaj periudhe*).
6. Lëvizja paralele në kategorinë ekzekutive dhe respektimi i kërkesave ligjore të parashikuara në nenin 25, të ligjit për nëpunësin civil, gjatë zhvillimit të kësaj procedure nga Komisioni i Brendshëm.
7. Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese dhe respektimi i procedurave të kërkuara nga neni 26, i ligjit për nëpunësin civil, nga njësia përgjegjëse dhe Komiteti i Pranimit gjatë zhvillimit të dy fazave të konkurrimit:
  - verifikimit paraprak;
  - vlerësimi i kandidatëve.

8. Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese dhe respektimi i kërkesave të nenit 32, të ligjit për nëpunësin civil nga ana e titullarit të institucionit (*respektimi i kufirit prej 15% të pranimit nga jashtë shërbimit civil*); respektimi i kërkesave ligjore nga ana e njësisë përgjegjëse për organizimin e konkurrimit dhe respektimi i procedurave të konkurrimit nga ana e Komisionit të Përhershëm të Pranimit, gjatë realizimit të procesit.
9. Probleme të ndryshme që i kanë lindur njësisë së menaxhimit të burimeve njerëzore (njësisë përgjegjëse), gjatë punës për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar.
10. **Aneks i programit:** Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes.
  1. Struktura organizative dhe analitike aktuale e institucionit.
  2. Struktura organizative dhe analitike e institucionit që ka qenë në fuqi në momentin e fillimit të efekteve të ligjit për nëpunësin civil.
  3. Listëprezenca dhe listëpagesa e punonjësve të institucionit për muajin Tetor 2023.
  4. Akti i deklaramentit të statusit të nëpunësit civil për shkak të ligjit, për punonjësit aktual të institucionit, nëse ka.
  5. Formulari i përshkrimit të punës për çdo pozicion që është përfshirë në procesin e plotësimit të vendeve të lira nëpërmjet pranimit nga jashtë në nivelin ekzekutiv, lëvizjen paralele dhe ngritjen në detyrë.
  6. Materialet që dokumentojnë procesin e rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.
    - Plani vjetor i rekrutimit ku të jetë përfshirë edhe nevoja për rekrutim nga jashtë shërbimit civil për pozicionet e ulta dhe të mesme drejtuese (20%) dhe të lartë drejtuese (15%).
    - Shpallja e vendit të lirë (*grup pozicionesh –nivel ekzekutiv/pozicion për ngritje në detyrë -nivel i lartë drejtues/nivel i ulët ose i mesëm drejtues*).
    - Kërkesa dërguar AKPA/shpallja në faqen e internetit të institucionit.
    - Aktet që vërtetojnë respektimin e afateve në shpallje (*sipas aktit nënligjor dhe udhëzimit të DAP*).
    - Aktet që materializojnë përbërjen e Komisionit të Përhershëm të Pranimit - për nivelin ekzekutiv.
    - Aktet që materializojnë procedurat e ndjekura për fazën e verifikimit paraprak:
    - Lëvizje paralele nivel ekzekutiv (*dërgimi për publikim në AKPA*);
    - Lëvizje paralele në nivelin e mesëm dhe të ulët (*dërgimi për publikim në AKPA*);

- Lista e kandidatëve të skualifikuar – arsyet dhe komunikimi me ta;
- Ankimimi;
- Aktet që materializojnë procesin e pranimit në shërbimin civil:
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*) në nivel ekzekutiv;
  - procesverbli i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPP /sekretimi;
  - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim; pyetjet e përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
  - pyetjet e intervistes me gojë;
  - deklarata e rregjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPP;
  - raporti i KPP për rezultatet (*para ankesave*);
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
  - shpallja e fituesit në AKPA;
  - deklarata e pranimit të pozicionit – rregjistrimi në listën e fituesve të atyre që nuk pranojnë pozicionin;
  - procedura e ankimimit nëse ka;
- Aktet që materializojnë procesin e ngritjes në detyrë:
  - akti që materializon ngritjen e Komitetit të Pranimit;
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar mbas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);
  - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;
  - procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
  - pyetjet e intervistës me gojë;
  - deklarata e rregjistrimit audio;
  - deklarata e paanësisë së KPND;
  - raporti i KPND;
  - vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues;
  - shpallja e fituesit në AKPA;
  - akti që materializon vendimin për pranimin në shërbimin civil sipas nenit 26/4 (*për 20%*) dhe për pranim në shërbimin civil, në nivelin e lartë drejtues (*për 15 %*);
  - verifikimi paraprak/verifikimi përfundimtar pas ankimimit (*nëse ka dhe dërgimi për publikim*);
  - procesverbali i prezencës në testimin me shkrim;
  - hartimi i tezës nga KPND /sekretimi;

- verifikimi i përgjigjeve të dhëna nga kandidatët e kualifikuar për testimin me shkrim sipas pyetjeve të përzgjedhura nga KPP për këtë fazë;
- procesverbali i prezencës në intervistën me gojë;
- pyetjet e intervistës me gojë;
- deklarata e regjistrimit audio;
- deklarata e paanësisë së KPND;
- raporti i KPND;
- vendimi për rezultatin përfundimtar të kandidatit fitues
- shpallja e fituesit në AKPA;
- akti i emërimit të punonjësve në pozicionin e shërbimit civil.

7. Dosjet e personelit dhe regjistri i personelit.

8. Materiale të tjera të cilat do të konsiderohen të domosdoshme për verifikimin e situatës së shërbimit civil në këtë institucion, gjatë procesit të mbikëqyrjes.

### **Metodologjia e mbikëqyrjes:**

Grupi i mbikëqyrjes ka zgjedhur si metodë pune verifikimin e dokumentacionit që ka lidhje me objektin e mbikëqyrjes, i cili administrohet në dosjet individuale të personelit, në arkivën e institucionit, si dhe në sektorin e shërbimeve mbështetëse, për çdo nëpunës të emëruar në pozicion pune pjesë e shërbimit civil.

Në zbatim të programit dhe drejtimeve të mbikëqyrjes, u ndërmorën veprimet e mëposhtme:

- Fillimisht u realizua një takim me njësinë përgjegjëse, gjatë të cilit u diskutua mbi qëllimin, programin dhe drejtimit e mbikëqyrjes, si dhe u ra dakord në lidhje me dokumentacionin shkresor që duhej t'i vihej në dispozicion grupit të mbikëqyrjes për verifikim.
- U verifikuan pozicionet e punës që janë pjesë e shërbimit civil, sipas organigramës dhe strukturës, të miratuar për Bashkinë Korçë.
- U verifikuan procedurat e pranimit në shërbimin civil, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë; dokumentet e administruara në dosjen e personelit që provojnë plotësimin e kërkesave të përgjithshme për pranimin në shërbimin civil sipas përcaktimeve të nenit 21 të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- U verifikuan të dhënat individuale të çdo nëpunësi civil, lidhur me përmbushjen e kërkesave specifike të pozicionit të punës si, niveli i diplomës së studimeve universitare, fusha kryesore e studimeve dhe përvoja në punë e lidhur me e arsimin e lartë që ka çdo nëpunës civil.

- U verifikua ligjshmëria e akteve të deklaramit të statusit të nëpunësit civil, për të gjithë ata nëpunës që e kanë përfituar këtë status sipas parashikimeve të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar.
- U administrua i gjithë dokumentacioni i kërkuar, në aneksin e programit (**Drejtimit e mbikëqyrjes**, pika 10. “**Aneks i programit: Aktet administrative që duhet të vihen në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes**”).

Të dhënat/gjetjet e konstatuara në lidhje me mënyrën e administrimit të shërbimit civil nga institucioni i mbikëqyrur janë të materializuara në **tabelat nr. 1 e nr. 2** dhe **procesverbalin e mbikëqyrjes** të hartuara nga grupi punës dhe që janë pjesë e këtij raporti.

Më konkretisht:

- *Tabela nr.1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Korçë”;*
- *Tabela nr.2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”.*

### **Përmbajtja e Raportit:**

**Si është kuptuar dhe zbatuar ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore të dala në bazë dhe për zbatim të tij, gjatë aplikimit në praktikë të procesit të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit të karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.**

#### **I. Situata e administrimit të burimeve njerëzore në momentin e mbikëqyrjes.**

Bashkia, si organ i vetëqeverisjes vendore, ka hyrë në skemën e administrimit të shërbimit civil me ligjin nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*” (i shfuqizuar) dhe ka ruajtur të njëjtin status edhe me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, pasi në nenin 2 të tij, përcaktohet se, ky ligj zbatohet për çdo nëpunës që ushtron një funksion publik në një institucion të administratës shtetërore, institucion të pavarur apo njësi të qeverisjes vendore.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, organet e qeverisjes vendore janë riorganizuar.



Konkretisht, në nenin 54 të ligjit, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak, në shkronjën “dh” përcaktohet se, **këshilli bashkiak** miraton buxhetin dhe numrin maksimal të punonjësve të bashkisë, si dhe të njërive e institucioneve buxhetore në varësi të bashkisë.

Ndërsa në nenin 64 të këtij akti ligjor, ku parashikohen detyrat dhe kompetencat e kryetarit të bashkisë, në shkronjën “j”, përcaktohet se, **kryetari i bashkisë**, miraton strukturën, organikën e kategoritë/klasat e pagave për çdo pozicion të shërbimit civil dhe rregulloret bazë të administratës së bashkisë dhe të njërive e institucioneve në varësi të bashkisë, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Nisur nga këto përcaktime ligjore, nga analiza e dokumentacionit që është vënë në dispozicion të grupit të mbikëqyrjes, konstatohet se, në momentin e mbikëqyrjes, Bashkia Korçë është e organizuar dhe funksionon mbi bazën e strukturës dhe organikës së miratuar me Vendimin nr.815, (nr. 6247 Prot.) datë 16.5.2023, të Kryetarit të Bashkisë Korçë “Për miratimin e strukturës së administratës së Bashkisë Korçë për vitin 2023”, ku përfshihen: numri i përgjithshëm i punonjësve për administratën e Bashkisë Korçë, shtatë Njësitë Administrative përbërëse të saj (Bulgarec, Drenovë, Mollaj, Vokopojë, Voskop, Vithkuq dhe Lekas), si dhe institucionet në varësi të kësaj bashkie.

Sipas kësaj strukture, **administrata e bashkisë**, ka gjithsej **378** pozicione pune, nga të cilat **185** pozicione pune, janë pjesë e shërbimit civil dhe në të, janë të përfshira edhe funksionet e njësive administrative që janë në varësi të kësaj bashkie.

Duke vlerësuar klasifikimin e pozicioneve të shërbimit civil, sipas përcaktimeve të nenit 19, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe vendimit nr. 142, datë 12.3.2014, të Këshillit të Ministrave “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar, pozicionet e punës, pjesë e shërbimit civil në administratën e Bashkisë Korçë, paraqiten në këtë raport:

- Nëpunës civilë të kategorisë së lartë drejtuese - **3 pozicione pune**, që i përkasin pozicionit të punës “Drejtor i Përgjithshëm”.
- Nëpunës civilë të kategorisë së mesëm drejtues - **14 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Drejtor Drejtorie”.
- Nëpunës civilë të kategorisë së ulët drejtues - **35 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Përgjegjës Sektori”.
- Nëpunës civilë të kategorisë ekzekutive - **133 pozicione pune**, të cilat i përkasin pozicionit “Specialist”.

Në mënyrë të detajuar, kjo gjendje është pasqyruar në **Tabelën nr. 1** - “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Korçë”, e cila është pjesë përbërëse e këtij raporti.

#### **I/1 Mënyra e plotësimit të pozicioneve të shërbimit civil në momentin e mbikëqyrjes në Bashkinë Korçë.**

Bazuar në strukturën dhe organikën që është në fuqi në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, Bashkia Korçë ka **185** pozicione të shërbimit civil, ku në momentin e kryerjes së verifikimit në institucion rezultojnë të plotësuara **107** pozicione, ndërsa **78** pozicione aktualisht janë të lira.

Nga verifikimi i dokumenteve të administruara në dosjen e personelit të krijuar për çdo nëpunës si dhe nga materialet e vëna në dispozicion nga njësia e burimeve njerëzore e cila administron çdo të dhënë në lidhje me aspektet e zhvillimit/menaxhimit të proceseve të burimeve njerëzore, mënyra e plotësimit të **107** pozicioneve të shërbimit civil në Bashkinë Korçë, gjatë periudhës objekt mbikëqyrje (viti 2021- viti 2023), paraqitet si më poshtë:

- ✓ **7 pozicione** pune pjesë e shërbimit civil janë plotësuar përmes **procedurës së ngritjes në detyrë**, bëhet fjalë për **1** pozicion “*Drejtor i Përgjithshëm*” dhe **6** pozicione “*Përgjegjës Sektori*”; n
- ✓ **4 pozicione** pune pjesë e shërbimit civil, me emërtesë “*Specialist*”; janë të plotësuara nëpërmjet **lëvizjes paralele**;
- ✓ **3 pozicione** punë pjesë e shërbimit civil, janë të plotësuara nëpërmjet **procedurës së pranimit nga jashtë shërbimit civil**, të ndara **2** pozicione “*Drejtor Drejtorie*” dhe **1** pozicion “*Përgjegjës Sektori*”;
- ✓ **21 pozicione** të shërbimit civil të kategorisë ekzekutive, janë të plotësuara nëpërmjet **procedurës së pranimit në shërbimin civil**;
- ✓ **19 pozicione** të shërbimit civil, janë të plotësuara me nëpunës civilë ekzistues;
- ✓ **52 pozicione** pune të shërbimit civil, janë të plotësuara nëpërmjet procedurave të konkurrimit të zhvilluara përpara periudhës objekt mbikëqyrje;
- ✓ **1 pozicion** pune i kategorisë ekzekutive, rezulton të jetë i plotësuar me emërim të përkohshëm.

**Konstatim:** Komisioneri konstaton se, me Urdhrin nr. 5, datë 20.01.2022 “*Për emërim të përkohshëm*”, të kryetarit të bashkisë, është emëruar në pozicionin “*Specialist për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Drenovë*” në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit të Territorit, punonjësja \*\*\*\*\*, e cila ka qenë e regjistruar në listë pritje, si rezultat i shpalljes fitues në një procedurë konkurrimi për pranim në shërbimin civil.

Lidhur me këtë procedurë emërimi theksojmë se, për çdo marrëdhënie të re pune në pozicione të shërbimit civil, duhet të respektohen detyrimisht kërkesat e një procedure të rregullt emërimi, të

përcaktuara në ligjin nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar (nenet 22, 23, 25 dhe 26 të tij), si dhe VKM nr. 243, datë 18.3.2015 “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimet në kategorinë ekzekutive” kapitulli V “Emërimi i përkohshëm”, ku theksohet se është njësi përgjegjëse organi që nxjerr aktin e emërimit të përkohshëm të nëpunësit, nëse ky i fundit jep pëlqimin e tij, në një pozicion pune i cili është vakant përkohësisht.

Në vijim të sa më sipër, njësi përgjegjëse duhet të nxjerrë aktin e emërimit të përkohshëm për punonjësen \*\*\*\*\*, në pozicionin “Specialist për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Drenovë” në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit të Territorit, në Bashkinë Korçë.

Vëmë në dukje se, emërimi i një kandidati fitues në mënyrë të përkohshme, nuk i heq atij të drejtën për t’u emëruar në mënyrë të përhershme në rast të krijimit të një pozicioni pune të lirë, gjatë kohës së vlefshmërisë së listës. Emërimi i përkohshëm, pavarësisht kohëzgjatjes së tij, nuk konsiderohet periudhë prove, në rast se kandidati fitues emërohet më pas në pozicion pune në mënyrë të përhershme.

## **II. Plani vjetor i pranimit në shërbimin civil**

Administrimi i shërbimit civil për të gjithë institucionet e administratës shtetërore bazohet në planin vjetor të pranimit në shërbimin civil, në zbatim të pikës 2, të nenit 18, të ligjit nr.152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të Vendimit nr. 108, datë 26.2.2014, të Këshillit të Ministrave, “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, në të cilin janë përcaktuar procedurat e hollësishme për përgatitjen, miratimin, afatin e miratimit dhe mënyrën e bërjes publike të planit vjetor të punësimit.

Përgatitja e tij në mënyrë të detajuar dhe në përputhje me kërkesat ligjore, përbën një garanci për zhvillimin e gjithë procedurave të konkurrimit.

Duke vazhduar më tej, në zbatim të detyrimeve të nenit 18, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, ku përcaktohet se: “.....çdo institucion i pavarur, jo më vonë se muaji shkurt, miratojnë planet e veta të pranimeve vjetore.....”, institucioni duhet të miratojë planin vjetor të pranimit për pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, në bazë të të cilave administrohet i gjithë procesi i rekrutimit.

Këto dispozita përcaktojnë se, institucionet e pavarura, në përgatitjen e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil, duhet të kenë parasysh nëpunësit që mbushin moshën për pensionin e plotë të pleqërisë, krijimin e vendeve të reja të punës pjesë e shërbimit civil për shkak të ndryshimit të strukturës, si dhe krijimin e vendeve të lira për arsye të tjera, të cilat publikohen në portalin: “Shërbimi Kombëtar i Punësimit”, në faqen zyrtare të internetit dhe në standat për njoftime publike të institucionit.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2021

Për vitin 2021, Këshilli i Bashkisë Korçë me vendimin nr. 14, datë 4.2.2021, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2021”, ka miratuar planin vjetor, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar procedurat e konkurrimit për **65** pozicione të lira, të ndara sipas kategorive:

- **1** pozicion i kategorisë së nivelit të lartë drejtues, (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme);
- **5** pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, (Drejtor drejtorie);
- **16** pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues, (Përgjegjës sektori);
- **43** pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv, (Specialistë).

Me tej, me vendimin nr. 115 prot., datë 30.9.2021, “Për disa ndryshime në VKB nr. 14, datë 04.02.2021, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2021””, të Këshillit të Bashkisë Korçë, është miratuar ndryshimi i planit vjetor, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar **63** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të shërbimit civil, të evidentuara si më poshtë:

- **1** pozicion i kategorisë së nivelit të lartë drejtues, (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme);
- **6** pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, (Drejtor drejtorie);
- **16** pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues, (Përgjegjës sektori);
- **40** pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv, (Specialistë).

Konstatohet se, vendet vakante të kategorisë ekzekutive janë klasifikuara në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm, duke përcaktuar për këto të fundit edhe fushën e arsimit apo njohurive shtesë që duhet të plotësojnë kandidatët për këto pozicione vakante.

Gjithashtu, në pikën 4, të vendimit është përcaktuar se, plotësimi i vendeve vakante për pozicionet e kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues (gjithsej **22** pozicione), do të bëhet përmes procedurës së lëvizjes paralele dhe/ose ngritjes në detyrë.

Përfundimisht, në zbatim të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, e cila parashikohen se, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik, është parashikuar se rekrutimi i nëpunësve për plotësimin e pozicioneve të kësaj kategorie, do të jetë i hapur edhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil, pasi të jetë ezauruar procedura e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë. Bëhet fjalë për këto pozicione pune:

- Drejtor i Drejtorisë së Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave;
- Përgjegjës i Sektorit për Emergjencat Civile;
- Përgjegjës i Sektorit të Turizimit dhe Projekteve;
- Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2022

Për vitin 2022, me Vendimin nr. 23, datë 10.2.2022 “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2022”, Këshilli i Bashkisë Korçë, i ndryshuar me Vendimin nr. 74, datë 28.4.2022 “Për disa ndryshime në VKB nr. 23, datë 10.02.2022, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2022” ”, si dhe Vendimin nr.106, datë 30.6.2022 “Për disa ndryshime në VKB nr. 23, datë 10.02.2022, “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin 2022” ”, të Këshillit të Bashkisë Korçë, ka miratuar planin vjetor, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar procedurat e konkurrimit për **76** pozicione të lira të ndara sipas kategorive:

- **2** pozicione të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme);
- **7** pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, (Drejtor drejtorie);
- **19** pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues, (Përgjegjës sektori);
- **48** pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv, (Specialistë).

Konstatohet se, edhe në planin e pranimit për vitin 2022, vendet vakante të kategorisë ekzekutive janë klasifikuara në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm. Gjithashtu, në pikën 4, të vendimit është përcaktuar se, plotësimi i vendeve vakante për pozicionet e kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të bëhet përmes procedurës së lëvizjes paralele dhe/ose ngritjes në detyrë.

Ndërsa për pozicionet vakante të evidentuara më poshtë:

- Drejtor i Drejtorisë së Projekteve, Turizmit, Teknologjive të Informacionit dhe Migracionit dhe Diasporës;
- Përgjegjës i Sektorit për Emergjencat Civile;
- Përgjegjës i Sektorit të Turizimit;
- Përgjegjës i Sektorit të Publikimeve,

në zbatim të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, procedura e plotësimit të vendeve të lira për këto dy kategori të ulët dhe të mesme drejtuese do të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe

kërkesat për vendin/vendet e lira, pasi të jetë ezauruar procedura e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

➤ Plani i Pranimit në Shërbimin Civil, viti 2023

Për vitin 2023, Këshilli Bashkiak me vendimin nr. 15, datë 25.1.2023 “Për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë, për vitin 2023”, ka miratuar planin vjetor, në bazë të të cilit janë parashikuar për t’u zhvilluar procedurat e konkurrimit për **86** pozicione të lira të ndara sipas kategorive:

- **1** pozicione i kategorisë së nivelit të lartë drejtues, (Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme);
- **7** pozicione të kategorisë së nivelit të mesëm drejtues, (Drejtor drejtorie);
- **17** pozicione të kategorisë së nivelit të ulët drejtues, (Përgjegjës sektori);
- **61** pozicione të kategorisë së nivelit ekzekutiv, (Specialistë).

Konstatohet se, edhe në planin e pranimit për vitin 2023, vendet vakante të kategorisë ekzekutive janë klasifikuara në grupet e administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm.

Gjithashtu, në pikën 4, të vendimit është përcaktuar se, plotësimi i vendeve vakante për pozicionet e kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues do të bëhet përmes procedurës së lëvizjes paralele dhe/ose ngritjes në detyrë dhe përjashtimit pas përfundimit të procedurës pa fitues, për pozicionet e mëposhtme, procedura do të jetë e hapur për pranim edhe me kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil. Bëhet fjalë për këto pozicione:

- Drejtor i Drejtorisë së Turizmit, Projekteve të Zhvillimit dhe Migracionit;
- Drejtor i Drejtorisë së Menaxhimit të Kontratave të Infrastrukturës dhe të tjera;
- Drejtor i Drejtorisë së Buxhetit dhe MFK;
- Përgjegjës i Sektorit të Turizimit;
- Përgjegjës i Sektorit të Menaxhimit të Kontratave;
- Përgjegjës i Sektorit të Strehimit Social.

Në lidhje me sa më sipër, konstatohet se, njësia përgjegjëse, ka vepruar në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar, si dhe me përcaktimet e Vendimit nr. 108, datë 26.02.2014, të Këshillit të Ministrave “Për planin vjetor të pranimit në shërbimin civil”, duke respektuar afatet e parashikuara për miratimin e planit vjetor të pranimit në shërbimin civil dhe evidentimin e procedurave të konkurrimit që do të zhvillohen për vitin, duke i ndarë në grupe të administrimit të përgjithshëm dhe grupe të administrimit të posaçëm në përputhje me përcaktimet e Vendimit nr. 142, datë 12.3.2014 “Për përshkrimin dhe klasifikimin e pozicioneve të punës në institucionet e administratës shtetërore dhe institucionet e pavarura”, i ndryshuar.

Njësia përgjegjëse e institucionit, në rastet e lindjes së nevojës së zhvillimit të procedurave të konkurrimit për pozicione të krijuara të lira pas miratimit të planit vjetor të rekrutimit, ka marrë masa për reflektimin e vakancës nëpërmjet ndryshimit të planit vjetor sipas kërkesave të akteve përkatëse nënligjore.

Në të gjitha aktet e miratimit të planit të pranimeve në shërbimin civil janë evidentuar nominalisht pozicionet vakante të kategorisë së nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, të cilat do të jenë të hapura për t'u plotësuar edhe me kandidatë nga jashtë shërbimit civil, sipas kërkesave të pikës 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 i ndryshuar, duke respektuar kufirin 20 % të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

### **III. Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv, nivelin e ulët, të mesëm drejtues dhe nivelit të lartë drejtues nëpërmjet konkurrimit dhe si janë respektuar kërkesat e nenit 22, 25, 26 dhe 32, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar dhe akteve nënligjore në lidhje me fazat e këtij procesi.**

Bazuar në kreun IV, V dhe VI, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, pozicionet e lira pjesë e shërbimit civil, plotësohen vetëm nëpërmjet procedurave të konkurrimit dhe njësi përgjegjëse për realizimin e procedurave të konkurrimit, është njësia e burimeve njerëzore të institucionit.

Për sa më sipër, Komisioneri verifikoi emërimet në pozicionet e shërbimit civil nëpërmjet procedurave të konkurrimit të hapur, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë të kryera në momentin e mbikëqyrjes.

#### **III/1 Plotësimi i pozicioneve të lira në shërbimin civil në nivelin ekzekutiv nëpërmjet procedurës së rekrutimit për periudhën 2021 - 2023**

Plotësimi i vendeve të lira në kategorinë ekzekutive të shërbimit civil nëpërmjet konkurrimit të hapur, rregullohet nga kreu IV, “Pranimi në shërbimin civil”, nenet 20, 21, 22, 23 e 25, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; Vendimi nr. 243, datë 18.3.2015, i Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, i ndryshuar, si dhe Udhëzimi nr. 2, datë 27.3.2015, i Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

Dispozitat ligjore si më sipër, përcaktojnë rregullat procedurale të konkurrimit, për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin ekzekutiv, sipas të cilave, për plotësimin e vendeve të lira në këtë rast, fillimisht organizohet *procedura lëvizjes paralele*, e më pas, nëse mbeten pozicione të

lira, pas aplikimit të procedurës së lëvizjes paralele, njësia përgjegjëse, i plotëson ato me anën e procedurës për pranimit në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive.

Nga analiza e të dhënave të administruara rezulton se, për periudhën objekt kontrolli, për pozicionet e punës që i përkasin kategorisë ekzekutive “Specialist”, (pozicione pune në të cilat punonjësit e emëruar janë aktualisht në marrëdhënie pune me institucionin) janë zhvilluar gjithsej **25** procedura, nga të cilat:

- **4** pozicion pune janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, ndërsa **21** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet pranimit në shërbimin civil.

✓ Në rastin konkret, janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele, **4** pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive “Specialist”, evidentuar punonjësit nominalisht si më poshtë:

1. \*\*\*\*\*, “Specialiste për regjistrimin, vlerësimin dhe shërbimit të taksapaguesve familjarë”, në Sektorin e Regjistrimit, Vlerësimit dhe Shërbimit të Taksapaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
2. \*\*\*\*\*, “Specialiste për regjistrimin, vlerësimin dhe shërbimin të taksapaguesve familjare”, në Sektorin e Regjistrimit, Vlerësimit dhe Shërbimit të Taksapaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
3. \*\*\*\*\*, “Specialiste për menaxhimin e borxhit të keq”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjes të të Ardhurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
4. \*\*\*\*\*, “Specialiste për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Lekas”, në Sektorin e Kontrollin dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.

✓ Nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, janë plotësuar përkatësisht **21** pozicionet e punës të kategorisë ekzekutive, në të cilat janë emëruar këta punonjës:

1. \*\*\*\*\*, “Specialiste për kadastrën fiskale, vlerësimin dhe shërbimin e taksapaguesve”, në Sektorin e Kadastrës Fiskale, Vlerësimit dhe Shërbimit të Taksapaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
2. \*\*\*\*\*, “Specialist për kontrollin dhe mbledhjen e të ardhurave”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjes të të Ardhurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit
3. \*\*\*\*\*, “Specialiste për menaxhimin e borxhit të keq”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjes të të Ardhurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.



4. \*\*\*\*\*, “*Specialist për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Vithkuq*”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
5. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Voskop*”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
6. \*\*\*\*\*, “*Specialist për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Voskop*”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
7. \*\*\*\*\*, “*Specialist projektues*”, në Sektorin e për Planifikimin e Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
8. \*\*\*\*\*, “*Specialist projektues*”, në Sektorin e për Planifikimin e Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
9. \*\*\*\*\*, “*Specialist për infrastrukturën mjedisore*”, në Sektorin e Mbrojtjes së Mjedisit dhe Eficencës së Energjisë, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
10. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për mbledhjen dhe përpunimin e të dhënave*”, në Sektorin për Administrimin e Regjistrimit të Territorit, në Drejtorinë e Planifikimit dhe Kontrollit të Territorit.
11. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Pagesave, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
12. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për ndihmën ekonomike*”, në Sektorin e Pagesave, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
13. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
14. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
15. \*\*\*\*\*, “*Specialiste për barazinë gjinore*”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
16. \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Strehimit Social, në Drejtorinë e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave.
17. \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Menaxhimit të Banesave Sociale, në Drejtorinë e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale.
18. \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
19. \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Buxhetit, Drejtoria e Buxhetit dhe MFK.
20. \*\*\*\*\*, “*Specialiste Auditit*”, në Drejtorinë e Auditimit të Brendshëm.
21. \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun.

Komisioneri, verifikoi në mënyrë të hollësishme të gjithë hapat proceduralë që ka ndjekur institucioni i mbikëqyrur, për menaxhimin e procesit të konkurrimit, nga ku u vërejt se nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit janë bërë përpjekje për të zbatuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil, duke kryer veprimet procedurale si më poshtë:

- a) Shpallja e konkurrimit për vendin e lirë është bërë në portalin e Agjencisë Kombëtare të Punësimit dhe Aftësive dhe është publikuar njoftimi në stendën e informimit të publikut për institucionin. Në shpallje ka të përcaktuar se, *aplikohet në të njëjtën kohë për të dy procedurat (lëvizje paralele, pranim në shërbimin civil)*, duke përcaktuar për secilën procedurë afatin e dorëzimit të dokumenteve me datë të saktë kalendarike;
- b) Në përmbajtje të shpalljes janë përfshirë të gjitha të dhënat e përcaktuara në pikën 9, të kreut II, si dhe në kreun VII, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, si dhe njësisë përgjegjëse është kujdesur për të realizuar procedura konkurrimi në grup, për pozicione pune të cilat lloji i diplomës që kërkohet dhe kërkesat e posaçme të pozicionit të punës janë të njëjta.
- c) Verifikimi paraprak nga njësia përgjegjëse është kryer në afatin e përcaktuar në shpalljen për konkurrim, nëse kandidatët i plotësojnë ose jo kërkesat e përgjithshme dhe ato të posaçme sipas shpalljes së konkurrimit;
- d) Vlerësimi i kandidatëve të kualifikuar për në fazën e dytë atë të intervistës së strukturuar me gojë, gjatë procedurës së lëvizjes paralele është bërë nga Komisioni i Brendshëm, sipas strukturës së pikëve të përcaktuar në udhëzimin përkatës të DAP;
- e) Vlerësimi i kandidatëve të kualifikuar për procedurën e pranimit është bërë nga Komiteti i Përhershëm i Pranimit (KPP), i cili përfshin vlerësimin e jetëshkrimit të kandidatëve, një testim me shkrim dhe intervistën e strukturuar me gojë (*për kandidatët të cilët kanë kaluar kufirin minimal të pikëve gjatë testimit me shkrim*);
- f) Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se, në çdo rast, si KBLP ashtu edhe KPP, për sa i përket përbërjes së tyre, janë ngritur në përputhje me përcaktimet ligjore;
- g) Në të gjitha rastet, anëtarët e tyre kanë firmosur deklaratën e paanësisë, duke deklaruar se nuk kanë konflikt interesi me kandidatët në konkurrim;
- h) Shpallja e listës së fituesve, administrimin e kësaj liste nga njësia përgjegjëse dhe nxjerrjen e aktit të emërimit në shërbimin civil për kandidatët fitues, janë kryer në përputhje me kërkesat e ligjit dhe VKM-së nr. 243, datë 18.03.2015, i ndryshuar;
- i) Lista e pritjes për kandidatët e shpallur fitues, ligji nr. 152/2013, “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, ka përcaktuar që në rastet kur, për një konkurrim janë shpallur më shumë fitues, se sa pozicionet vakante për të cilat është zhvilluar procedura e hapur e konkurrimit, njësia përgjegjëse, në zbatim të nenit 23, pika 3, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe pikës 18, të kreut IV, të vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i rendit kandidatët fitues, të cilët nuk janë emëruar për shkak të mungesës së vendeve vakante apo për shkak të refuzimit të ligjshëm, në një listë me vlefshmëri 2- vjeçare. Nëse gjatë kësaj periudhe njësia përgjegjëse zhvillon

një procedurë konkurrimi për të njëjtin grup pozicionesh, kandidatët fitues, të paemëruar ende, rirenditen në listën fituese të konkurrimit përkatës sipas rezultatit përfundimtar.

Komisioneri konstatoi se, njësia përgjegjëse ka administruar listën e pritjes dhe kandidatët e shpallur fitues të listuar në listjen e pritjes dhe i ka sistemuar në pozicione të shërbimit civil, ku ata plotësonin kriteret e përgjithshme dhe të posaçme të pozicionit.

Aktualisht, vijon të jetë në listë pritje vetëm një punonjëse, bëhet fjalë për \*\*\*\*\*, shpallur fituese në procedurën e konkurrimit për plotësimin e pozicionit “*Specialist në sektorin e marrëdhënieve me publikun*”.

Në të gjitha rastet e shpalljes së vendeve të lira, rezultoi se, janë respektuar afatet e parashikuara në pikën 8 e 10, të kreut II, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, pika 9, kreu II, e VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, ku përcaktohet se, shpallja e procedurës së pranimit bëhet të paktën 35 ditë kalendarike para datës së parashikuar për zhvillimin e konkurrimit; afati i dorëzimit të dokumentacionit për lëvizje paralele jo më pak se 10 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes; për pranim në shërbimin civil jo më pak se 15 ditë kalendarike nga dita e parë e shpalljes.

✓ **Problematikat e evidentuara sa i përket aspektit procedural, gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për pranimin në shërbimin civil.**

a) Me urdhër të titullarit të institucionit për ngritjen e Komitetit të Përhershëm të Pranimit, ky komision është ngritur i veçantë për secilën procedurë konkurrimi në nivelin ekzekutiv, në kundërshtim me kërkesat e pikës 2, të kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, e cila parashikon se, KPP-ja krijohet për çdo grup administrimi të përgjithshëm apo të posaçëm dhe përtërihet çdo vit, me përbërje 5 anëtarë, cilësia dhe numri i të cilëve përcaktohet në mënyrë shteruese në këtë akt nënligjor.

Sipas parashikimit ligjor të nenit 22, të ligjit 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe atij nënligjor të përcaktuar në pikën 2, të kreut III, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015 “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”, i ndryshuar, ku citohet se: “*Komiteti i Përhershëm i Pranimit për nivelin ekzekutiv pranë institucioneve të pavarura dhe njërive të qeverisjes vendore krijohet një komitet i përhershëm i pranimit për secilin institucion*”, përcaktohet se, KPP krijohet në fillim të vitit dhe ka të njëjtën përbërje për të gjitha procedurat e konkurrimit për pranim në shërbimin civil të zhvilluara gjatë vitit.

- b) Procedura e konkurrimit në disa raste, nuk është protokolluar në një numër protokoll, por në numra protokoll të ndryshëm, për shkak të dërgimit pranë SHKP-së me një shkresë të vetme, në grup, njoftimet për shpallje të pozicioneve vakante.

Kjo krijon problematikë në evidentimin e faktit, nëse një procedurë konkurrimi e zhvilluar për pranimin në kategorinë ekzekutive, ka respektuar kërkesat e parashikuara në legjislacionin e shërbimit civil, sa i përket fazave nëpër të cilën ajo duhet të kalojë.

- c) Në disa akte të administruara në dosjet e konkurrimit, konstatohet se ka gabime materiale sa i takon titullit të aktit apo përmbajtjes së tij, për të cilat duhet të tregohet kujdes në të ardhmen gjatë përpilimit të tyre, nga njësia përgjegjëse apo Komitetet, por këto gabime janë të një natyre që nuk çënon ligjshmërinë e procedurës së konkurrimit.
- d) Në të gjitha procedurat e konkurrimit të këqyrura, për pranimin në shërbimin civil, deklarata e regjistrimit me zë të intervistës së strukturuar me gojë për kandidatët mungon. Sjellim në vëmendje të njësisë përgjegjëse se, procedura e konkurrimit për pranimin në shërbimin civil, duhet të ndjekin të gjitha fazat e parashikuara në nenet 22, 23 dhe 25, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, me qëllim garantimin e procedure konkurrimi të ligjshme dhe transparente, duke i dhënë mundësinë të gjithë kandidatëve dhe palëve pjesëmarrëse në proces ta ndjekin atë në secilën fazë, deri në daljen e rezultatit përfundimtar.

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, me qëllim që të rregullohet situata e administrimit të shërbimit civil, nga ana e njësisë përgjegjëse, duhet të plotësohen mangësitë e konstatuara, edhe pse ato nuk janë të asaj natyre që të sjellin paligjshmërinë apo pavlefshmërinë absolute të procedurës së konkurrimit.

### **III/1/a. Respektimi i kërkesave të ligjit dhe procedurës gjatë përmbushjes së periudhës së provës.**

Në lidhje me këtë institut të ligjit, ku rregullohet procesi i emërimit të nëpunësit për herë të parë në shërbimin civil dhe që zgjat një vit nga data e aktit të emërimit, nga ana e grupit të mbikëqyrjes u verifikua përmbushja e kërkesave ligjore që duhet të respektohen gjatë kësaj periudhe të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, të ndryshuar; si dhe kreu VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive*”.

Në mbështetje të këtyre dispozitave ligjore, nëpunësi në periudhë prove është i detyruar të ndjekë programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës pranë ASPA-s dhe udhëzimet e nëpunësit më të vjetër civil, nën kujdesin e të cilit ai është vendosur. Eprori direkt i nëpunësit në periudhë prove, duhet të caktojë nëpunësin më të vjetër nën kujdesin e të cilit do të vendoset

nëpunësi civil në periudhë prove, e më tej, duhet të kryej vlerësimin e rezultateve individuale në punë për periudhën e provës dhe të nxjerrë vendimin për përfundimin e periudhës së provës.

Në zbatim të planit të mbikëqyrjes, u verifikua tërësia e veprimeve të kryera për konfirmimin e nëpunësve civilë, të cilët i janë nënshtruar periudhës së provës dhe që aktualisht vazhdojnë marrëdhëniet e punësimit me institucionin.

Në institucionin e mbikëqyrur për periudhën objekt kontrolli, siç edhe e kemi sqaruar më lart, janë zhvilluar **25** procedura konkurrimi për nivelin ekzekutiv, u konstatua se **4** pozicione pune janë plotësuar nëpërmjet lëvizjes paralele dhe **21** pozicione pune nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil, nga këto konstatohet se, për **11** punonjës ka mbaruar periudha e provës, për të cilët kanë dalë aktet e konfirmimit si nëpunës civilë, ndërsa **10** punonjës janë në periudhë prove.

❖ Për **11** punonjësit për të cilët ka përfunduar periudha e provës, konstatohet se, janë respektuar kërkesat e legjislacionit të shërbimit civil të përcaktuara nga neni 24, i ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar; si dhe kreut VI, i Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”, si vijon:

- Nëpunësi në periudhë prove, për të gjithë periudhën 1 vjeçare ka qenë në kujdestari të një nëpunësi me të vjetër civil në njësinë organizative ku bën pjesë punonjësi, ky nëpunës në fund të periudhës së provës ka dhënë mendimin me shkrim, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit 24, të ligjit 152/2013, i ndryshuar dhe pika 2, germa b), kreu VI, të VKM-së nr.243, datë 18.3.2015, i ndryshuar;
- Konstatohet se në të gjitha rastet, nëpunësit në periudhë prove, kanë ndjekur pranë ASPA-s, programin e detyrueshëm të trajnimit për periudhën e provës. Certifikata/dëshmia që provon kalimin me sukses të testimit në përfundim të programit të trajnimit e lëshuar nga ASPA, është administruar në dosjen e personelit të çdo nëpunësi civil, në përputhje me parashikimin e pikës 2, germa a), kreu VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar;
- Formulari i vlerësimit për periudhën e provës është administruar në dosjen e personelit, në ligjin për nëpunësin civil, vendimi i eprorit direkt për konfirmimin e nëpunësit civil, bazohet në çdo rast në vlerësimin e rezultateve individuale në punë, për gjithë periudhën e provës. Ndërsa në pikën 6, germa b), të kreut VI, të VKM-së nr. 243, datë 18.3.2015, i ndryshuar, parashikohet se, në përfundim të periudhës së provës, vlerësimi i rezultateve individuale në punë, bëhet sipas procedurave të përcaktuara në aktin nënligjor për vlerësimin e arritjeve vjetore (VKM nr. 109, datë 26.2.2014, i ndryshuar), i cili në pikën 2, të kreut II, ka parashikuar se: “... Vlerësimi i rezultateve në punë në përfundim të

periudhës së provës është vjetor dhe llogaritet nga data e emërimit të nëpunësit civil në detyrë”.

**Konstatohet se**, në formularin e vlerësimit të rezultateve në punë, në disa raste, mungojnë komentet e zyrtarit raportues, të cilat janë element i nevojshëm për të vlerësuar objektivitetin e zyrtarit në përcaktimin e nivelin të vlerësimit të rezultateve në punë gjatë periudhës së provës, kjo problematikë duhet të mbahet në vëmendje nga zyrtarët vlerësues për mos përsëritjen në të ardhmen.

- ❖ Ndërsa **10** punonjësit për të cilët ende vazhdon periudha e provës, janë të paraqitur nominalisht si më poshtë:
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste për kadastrën fiskale, vlerësimin dhe shërbimin e taksapaguesve*”, në Sektorin e Kadastrës Fiskale, Vlerësimit dhe Shërbimit të Taksapaguesve, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste për menaxhimin e borxhit të keq*”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjes të të Ardhurave, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative Voskop*”, në Sektorin e Kontrollit dhe Mbledhjen e të Ardhurave për Njësitë Administrative, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontroll Territorit.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Pagesave, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste për ndihmën ekonomike*”, në Sektorin e Pagesave, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve*”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste për barazinë gjinore*”, në Sektorin e Shërbimeve Sociale, në Drejtorinë e Kujdesit Social.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialist*”, në Sektorin e Strehimit Social, në Drejtorinë e Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Kontabilitetit, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit.
  - ✓ \*\*\*\*\*, “*Specialiste*”, në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun.

**Konkluzion:** Nga sa analizuam më sipër, vlerësohet se, gjatë procedurës së vendimmarrjes në fund të periudhës së provës nga eprori direkt, konstatohen parregullsi sa i takon plotësimit me komente të rubrikave të formularit të vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit në përfundim të periudhës së provës. Në të ardhmen, duhet të mbahet parasysh që në të ardhmen kjo mangësi të mos përsëritet dhe, procedura e vendimmarrjes në fund të periudhës së provës, të jetë e plotësuar me të gjithë elementët, sipas kërkesave të ligjit.

### **III/2. Procedura e lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë për pozicionet e nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues.**

Rregullat procedurale të konkurrimit për të plotësuar pozicionet e punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, (*lëvizja paralele dhe ngritja në detyrë*), janë të parashikuara në nenet 25 dhe 26, të ligjit nr. 152/2013 “*Për nëpunësin civil*”, i ndryshuar, si dhe Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “*Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese*”.

Sipas përcaktimeve të mësipërme ligjore, edhe për këtë procedurë plotësimi i vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, bëhet së pari, nga nëpunësit civil të së njëjtës kategori, nëpërmjet *procedurës së lëvizjes paralele*, e nëse me anën e kësaj procedure pozicionet e lira nuk plotësohen, atëherë vijon procedura për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët dhe të mesme drejtuese, me *procedurën konkurruese ngritje në detyrë*.

Nga analiza e të dhënave të grumbulluara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezulton se, për periudhën objekt mbikëqyrje, Janar 2021 - Shtator 2023, nga njësia përgjegjëse e institucionit të Bashkisë Korçë, janë shpallur **9** procedura konkurrimi për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, nga këto, **6** procedura kanë përfunduar në *fazën e ngritjes në detyrë* dhe **3** procedura konkurrimi kanë përfunduar në *fazën e pranimit nga jashtë shërbimit civil*.

#### **III/2.a Procedura konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të kategorisë së nivelit të ulët dhe mesëm drejtues, me procedurë ngritje në detyrë:**

Sipas akteve të administruara gjatë procesit të mbikëqyrjes, rezultoi se, **6** procedura konkurrimi kanë përfunduar me procedurë ngritje në detyrë, nga punonjës pjesë e shërbimit civil brenda institucionit, bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune:

- \*\*\*\*\* , emëruar me vendimin nr. 44, datë 28.9.2022, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “*Përgjegjëse e sektorit të kadastrës fiskale, vlerësimit dhe shërbimit të taksapaguesve*”, në Drejtorinë e Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit Territorit;
- \*\*\*\*\* , emëruar me vendimin nr. 1, datë 5.1.2023, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “*Përgjegjës i sektorit për mbledhjen e të ardhurave*”, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit Territorit;
- \*\*\*\*\* , emëruar me vendimin nr. 25, datë 17.8.2021, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “*Përgjegjës për mbledhjen e të ardhurave për njësinë administrative*”, Drejtoria e Përgjithshme e Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit Territorit;

- \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 16, datë 4.4.2023, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “Përgjegjës i sektorit të IT”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 24, datë 12.9.2023, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “Përgjegjës sektori i Financës”, Drejtoria e Financës dhe Kontabilitetit;
- \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 39, datë 6.7.2022, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “Drejtor i Drejtorisë së Pyjeve dhe Kullotave”, Drejtoria e Përgjithshme e Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit.

Nga këqyrja e materialeve rezulton se, për **6** rastet e ngritjes në detyrë, nga kandidatë të brendshëm, në të gjitha rastet, kandidatët që kanë aplikuar për këtë procedurë, i plotësojnë kushtet minimale dhe kërkesat e veçanta sipas shpalljes për konkurrim, të përcaktuara në pikën 2, të kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar, të cilat janë si më poshtë:

- janë nëpunës civilë të konfirmuar, me kategori page sipas përcaktimit në shpallje, e vërtetuar në të gjitha rastet me aktet përkatëse të konfirmimit të statusit nga institucionet ku ata kanë qenë më parë;
- nuk kanë masë disiplinore në fuqi, të vërtetuar me akt zyrtar të institucionit ku ata kryejnë detyrën në momentin e konkurimit dhe ,
- vlerësimet e punës për periudhën e fundit, sipas formatit të vlerësimit, të nënshkruar nga nëpunësit pjesëmarrës në vlerësim, janë në të gjitha rastet, në nivelin “*Mirë*” ose “*Shumë mirë*”;

Sa i përket aspektit procedural të zhvillimit të procedurës së konkurimit, u konstatuan se, në të **6** procedurat e konkurimit të zhvilluara mungon deklarata e pranimit të regjistrimit me zë të kandidatit, gjatë intervistës së strukturuar me gojë.

Kjo parregullsi në procedurën e konkurimit nuk çënon ligjshmërinë e procesit, por, duhet të mbahet në vëmendje në të ardhmen për ta plotësuar atë në përputhje me kërkesat e aktit nënligjor, VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar.

✓ Ndërsa **3** procedura konkurimi kanë përfunduar me procedurë ngritje në detyrë **me kandidatë nga jashtë shërbimit civil**, bëhet fjalë për punonjësit e emëruar në këto pozicione pune:

- \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 42, datë 30.8.2022, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse, “Përgjegjës i sektorit të emergjencave civile”, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Protokoll Arkivës dhe Shërbimeve Mbështetëse;
- \*\*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 32, datë 19.4.2022, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “Drejtor e Drejtorisë së Kujdesit Social”, Drejtoria e Përgjithshme Juridike dhe e Menxhimit të Burimeve Njerëzore;



- \*\*\*\*\*, emëruar me vendimin nr. 37, datë 7.12.2021, të Kryetarit dhe njësisë përgjegjëse “Drejtores e Drejtorisë së Strehimit Social dhe Menaxhimit të Banesave Sociale”, Drejtores e Përgjithshme Juridike dhe e Menxhimit të Burimeve Njerëzore.

Ligji nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në pikën 4, të nenit 26, parashikon se, procedura e plotësimit të vendeve të lira për kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese mund të jetë e hapur edhe për kandidatë të tjerë, nga jashtë shërbimit civil, që plotësojnë kushtet dhe kërkesat për vendin/vendet e lira. Në çdo rast plotësimi i vendeve të lira në këtë kategori nuk mund të kalojë 20% të numrit total të vendeve në çdo vit kalendarik.

Nëpërmjet këtij rregulli përjashtues, një numër i kufizuar pozicionesh të cilat normalisht do të ishin të hapura për konkurrim vetëm për nëpunësit civil, hapen edhe për kandidatë nga jashtë, nëse procedurat e lëvizjes paralele apo ngritjes në detyrë rezultojnë pa fitues, ky numër pozicionesh dhe emërtesa e tyre është specifikuar qartë në planin e rekrutimit (e sqaruar gjerësisht në nënçështjen që analizon planin e rekrutimit).

Në aktet e materializuara në dosjet e konkurrimit për plotësimin e pozicioneve të nivelit të ulët dhe të mesëm drejtues, përmes pranimit nga jashtë shërbimit civil, u konstatuan se, njësisia përgjegjëse ka krijuar “Komitetin e Përhershëm të Pranimit nga Jashtë Shërbimit Civil”, për 3 procedurat e konkurrimit të zhvilluara për plotësimin e pozicioneve të punës në nivelin e ulët dhe të mesëm drejtues, nëpërmjet pranimit nga jashtë shërbimit civil, emërtesa e Komitetit nuk është sipas përcaktimeve ligjore, ndërsa përbërja e tij është në përputhje me kërkesat e pikës 7, të kreut III, të VKM-së nr. 242, datë 18.3.2015, i ndryshuar. Sipas përcaktimit në këtë akt nënligjor, vlerësimi i kandidatëve për procedurën nga jashtë shërbimit civil bëhet nga Komiteti i Pranimit për Ngritjen në Detyrë (KPND).

Në pikën 43, të kreut III, të aktit nënligjor, përcaktohet se, në rast se një vend vakant në kategorinë e ulët apo të mesme drejtuese, nuk plotësohet nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele dhe organi kompetent për institucionet e tjera, që në këtë rast njehsohet me titullarin e institucionit, ka marrë vendim në përputhje me pikën 4, të nenit 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, atëherë në procedurën e ngritjes në detyrë kanë të drejtë të konkurrojnë edhe kandidatë të tjerë nga jashtë shërbimit civil.

Pra, procedura e konkurrimit për pranim nga jashtë shërbimit civil, do të kalojë në të njëjtat faza me atë të ngritjes në detyrë. Komiteti për vlerësimin e kandidatëve do të jetë KPND edhe për këtë procedurë.

**Konkluzion:** Gjatë zhvillimit të procedurave të konkurrimit për të dy fazat, ngritje në detyrë dhe pranim nga jashtë shërbimit civil, për plotësimin pozicionet e punës të evidentuara më lart, nga ana e njësisë përgjegjëse të institucionit, në përgjithësi është bërë përpjekje për të përmbushur rregullat e përcaktuara në nenin 26, të ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar,

Vendimin nr. 242, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave “Për plotësimin e vendeve të lira në kategorinë e ulët drejtuese dhe të mesme drejtuese”, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 27.3.2015, të Departamentit të Administratës Publike “Për procesin e plotësimit të vendeve të lira në shërbimin civil nëpërmjet procedurës së lëvizjes paralele, ngritjes në detyrë për kategorinë e mesme dhe të ulët drejtuese dhe pranimin në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive nëpërmjet konkurrimit të hapur”.

### **III/3 Pranimi i nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese.**

Përsa i përket pranimin të nëpunësve civilë të kategorisë së lartë drejtuese nga këqyrja e strukturës dhe organikës në fuqi, rezulton se, në institucionin e mbikëqyrur janë **3** pozicione të kategorisë së nivelit të lartë drejtues, me emërtesë “Drejtor i Përgjithshëm”, nga këto pozicione, **1** pozicion “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Taksave, Tarifave Vendore dhe Kontrollit Territorit” rezulton vakant në momentin e mbikëqyrjes, ndërsa **2** pozicione të kategorisë së lartë drejtuese janë të plotësuara, nga të cilat:

- Pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme Juridike dhe e Menxhimit të Burimeve Njerëzore”, është plotësuar nëpërmjet procedurës “ngritje në detyrë” përpara periudhës objekt mbikëqyrje.
- Pozicioni “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, në të cilin është emëruar punonjësj \*\*\*\*\*, është plotësuar përmes procedurës “ngritje në detyrë”, dërguar për publikim pranë AKPA-së me shkresën nr. 3150 prot., datë 26.4.2022.

Grupi i mbikëqyrjes këqyri dokumentacionin e administruar në dosjen e konkurrimit për plotësimin e pozicionit të punës “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, pozicioni i kategorisë së nivelit të lartë drejtues, në institucionin e kontrolluar rezultoi se, procedura e ndjekur nga njësia përgjegjëse, për plotësimin e vendit vakant paraqitet si më poshtë vijon:

- Me vendimin nr. 23, datë 10.2.2022 “Për miratimin e planit vjetor të pranimin në shërbimin civil për institucionin e Bashkisë Korçë për vitin”, të Këshillit të Bashkisë Korçë, është planifikuar për t’u plotësuar përmes procedurës së konkurrimit **2** pozicione të kategorisë së nivelit të lartë drejtues.
- Njësia përgjegjëse, me shkresën nr. 3150 prot., datë 26.4.2022, ka dërguar për publikim shpalljen e procedurës për plotësimin e vendit vakant, në kategorinë e nivelit të lartë drejtues, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”; në Faqen Zyrtare; si dhe në stendën e informimit të publikut të institucionit.
- Në dosjen e konkurrimit gjendet shpallja për lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, me nr.3150 prot., datë 26.4.2022, në të cilën është planifikuar procedura e konkurrimit për pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit

*Financiar dhe Kontrollit*”, pranë Bashkisë Korçë. Në njoftimin për shpallje është planifikuar lëvizje paralele dhe ngritje në detyrë, duke përcaktuar afatet për procedurën e lëvizjes paralele/ngritjes në detyrë, afatin e dorëzimit të dokumentacionit dhe verifikimit paraprak, për të dy fazat e konkurrimit.

- Konstatohet se, janë respektuar kërkesat e parashikuara në pikat 7 deri 10, të kreut VIII, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 118, datë 5.3.2014 *“Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”*, i ndryshuar, sa i takon afatit të dorëzimit të dokumentacionit nga kandidatët, si dhe afatit të verifikimit paraprak, nga ana e njësisë përgjegjëse.
- Njësia përgjegjëse, ka kryer verifikimin paraprak dhe verifikimin përfundimtar pas përfundimit të afatit të ankimit dhe në të gjitha rastet i ka dërguar shkresat me rezultatet e verifikimit për publikim pranë AKPA-së, për të dy fazat e konkurrimit lëvizje paralele (shkresa nr. 3150/1 prot., datë 9.5.2022) dhe ngritje në detyrë (shkresa nr. 3150/2 prot., date 23.5.2022).
- Komiteti i Përhershëm i Pranimit për pranimin në kategorinë e nivelit të lartë drejtues është ngritur urdhrin nr. 490, (nr. 4746 prot.), datë 26.5.2022 *“Për ngritjen e Komitetit të Pranimit për Ngritjen në Detyrë për nivelin e lartë drejtues”*, të titullarit të institucionit, me përbërje:
  - \*\*\*\*\* (Drejtor i Përgjithshëm);
  - \*\*\*\*\* (Drejtor Drejtorie);
  - \*\*\*\*\* (Drejtor Drejtorie);
  - \*\*\*\*\* (Ekspert i Jashtëm);
  - \*\*\*\*\* (Ekspert i Jashtëm).

Konstatohet se, përbërja e KPP-së është në përputhje me kërkesat e pikës 12, të kreut VIII, të VKM-së nr. 118, datë 5.3.2014 *“Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”*, i ndryshuar.

- Pas verifikimit paraprak, me e-mail datë 23.5.2022, është njoftuar për datën e testimit me shkrim, kandidati i kualifikuar për procedurën e konkurrimit ngritje në detyrë, \*\*\*\*\*.
- Në dosjen e konkurrimit gjenden aktet administrative të kërkuara, të cilat dokumentojnë fazat e konkurrimit, të testimit me shkrim (datë 1.6.2022) dhe intervistës së strukturuar me gojë (datë 8.6.2022).
- Me Vendimin e KPP-së me nr. 3150/4 prot., datë 9.6.2022, *“Për rezultatin e procedurës për ngritje në detyrë”*, në përfundim të procedurës së konkurrimit është shpallur emri i kandidatit fitues \*\*\*\*\*, për pozicionin *“Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”*, në Bashkinë Korçë, me rezultatin 96 pikë.

- Lista përfundimtare e fituesve, me shkresën nr. 3150/5 prot., datë 9.6.2022, të njësisë përgjegjëse, është publikuar në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”; në faqen zyrtare të internetit dhe në ambientet e përcaktuara nga njësia e qeverisjes vendore, në respektim të kërkesave të pikës 14, të kreut VIII, të VKM-së nr. 118, datë 5.3.2014 “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar. Ndërsa, me e-mailin e datës 14.6.2022, të njësisë përgjegjëse, i është dërguar AKPA-së, rezultati për shpalljen e fituesit.
- Në përfundim të vlerësimit nga Komiteti, ka dalë akti i emërimit nr. 37, datë 14.06.2022, për kandidatin fitues \*\*\*\*\*\*, nga titullari i institucionit dhe njësia përgjegjëse.
- Në dosjen e konkurrimit gjenden edhe shkresa nr. 4639 prot., datë 23.5.2022, “Dërgim i formularit të aplikimit të \*\*\*\*\*” drejtuar Autoritetit për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, për verifikimin e pastërtisë së figurës së kandidatit fitues. Në përgjigje të kësaj kërkesë, me shkresën nr. 884/3 prot., datë 27.6.2022, institucioni Autoriteti për Informimin mbi Dokumentat e ish-Sigurimit të Shtetit, ka dërgur pranë Bashkisë Korçë, informacion mbi rezultatin e verifikimit të figurës të \*\*\*\*\*.

**Konkluzion:** Në rastin e emërimit të punonjësit \*\*\*\*\*\*, në pozicionin “Drejtor i Drejtorisë së Përgjithshme të Financës, Buxhetit dhe Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit”, në Bashkinë Korçë, njësia përgjegjëse dhe KPP, kanë ndjekur procedurat e konkurrimit në përputhje me kërkesat ligjore dhe nënligjore për ngritjen në detyrë, për kategorinë e nivelit të lartë drejtues, të parashikuara në nenin 32, të ligjit nr. 152/2013, i ndryshuar dhe në VKM-në nr. 118, datë 5.3.2014, “Për procedurat e emërimit, rekrutimit, menaxhimit dhe përfundimit të marrëdhënies në shërbimin civil të nëpunësve civilë të nivelit të lartë drejtues dhe të anëtarëve të TND-së”, i ndryshuar, kreu VIII.

#### **Të tjera:**

Trajtim i informacionit të ardhur me shkresën nr. 841 prot., datë 28.8.2023, për përfundimin e procesit të vlerësimit të ligjshmërisë së procedurës së konkurrimit për pranim në shërbimin civil, për pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, në Bashkinë Korçë.

Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, nëpërmjet informacionit të regjistruar me nr.841 prot., datë 28.8.2023, dërguar nga konkurrentja \*\*\*\*\*\*, është vënë në dijeni për disa pretendime që kanë të bëjnë me parregullsi të kryera në fazën e paraseleksionimit, gjatë kryerjes së procedurës së konkurrimit për pranim në shërbimin civil, për pozicionin “Specialist në Sektorin e Marrëdhënieve me Publikun”, në Bashkinë Korçë, informacioni i cili u verifikua gjatë mbikëqyrjes në institucion.

Në përmbajtje të informacionit, kandidatja \*\*\*\*\* parashtron se, pas verifikimit paraprak të dokumentacionit të kandidatëve, ajo është s'kualifikuar për të marrë pjesë në procedurën e konkurrimit, me pretendimin se dokumentacioni i paraqitur nuk ishte i plotë pasi, *“Vërtetimi i gjendjes shëndetësore”* dhe *“Formulari i vetdeklarimit”*, ishin fotokopje dhe jo origjinale. Megjithëse, brenda afatit ligjor kandidatja ka plotësuar të metat e mësipërme, duke paraqitur dokumentacionin e kërkuar, ankesa nuk është pranuar dhe kandidatja në fjalë, përfundimisht nuk ka mundur të marrë pjesë në konkurrim.

Me pretendimin se veprimi i mësipërm administrativ, për skualifikimin nga pjesëmarrja në procedurën e konkurrimit është i padrejtë, konkurrentja \*\*\*\*\* ka informuar Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil në lidhje me sa më sipër duke kërkuar ndërhyrjen e tij për rivendosjen e gjendjes së ligjshmërisë.

Pas kryerjes së verifikimit paraprak të informacionit të mësipërm konstatohet se, njësia përgjegjëse bazuar në pikën 3, germa a), e nenit 22, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar dhe pikën 5, të kreut IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.3.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, ka vepruar brenda kompetencave të saj në procesin e verifikimit të dokumentacionit të dorëzuar, për të vlerësuar nëse konkurrentët i plotësonin ose jo kushtet për pjesëmarrje në këtë konkurrim.

Në përfundim të këtij procesi është vendosur moskualifikimi i kandidatës \*\*\*\*\* , për të marrë pjesë në fazën e dytë të konkurrimit, pasi dokumentacioni i paraqitur nuk ishte në formën e kërkuar ligjore. Ky vendim i është njoftuar kësaj të fundit, me *e-mail* në datën 21.8.2023 me arsyetimin se *“Vërtetimi për gjendjen shëndetësore”* dhe *“Formulari i vetdeklarimit”* nuk ishin origjinale apo të njehsuara me origjinalin, por fotokopje e për këtë arsye ajo është s'kualifikuar. Në këtë njoftim, mbështetur në pikën 6, të kreut IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, është nënvizuar e drejta e konkurrentes se, *“Ju keni të drejtë të paraqisni ankesë me shkrim brenda 5 ditëve kalendarike... ankimi i cili do të shqyrtohet brenda 5 ditëve nga data e depozitimit”*.

Mbi bazën e këtij njoftimi, kandidatja \*\*\*\*\* brenda afatit, ka dërguar pranë Bashkisë Korçë dokumentacionin në formën e kërkuar, në datën 22.8.2023 (*marrë në dorëzim nga bashkia në dt.23.8.2023*).

Në vijim të komunikimit, nga ana e burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, brenda afatit 5 ditor për shqyrtimin e ankesës së paraqitur, është kthyer përgjigje me *e-mail* se, dokumentacioni i paraqitur rishtas nuk mund të pranohet pasi ai duhej të ishte dorëzuar në formën e duhur brenda afatit të përcaktuar në shpallje dhe se afati 5 ditor i ankimit përmendur në aktin e komunikimit nuk nënkupton plotësimin e mangësive në dokumentacion, por vetëm mundësinë për të

kontestuar një shkelje të mundshme nga ana e njësisë së burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, në lidhje me procesin.

Pra, njësia e burimeve njerëzore të Bashkisë Korçë, në interpretim të të kundërtës të përgjigjes së saj, mban qëndrimin se ankesa e konkurrentes mund të pranohej vetëm nëse s'kualifikimi i saj do të ishte rrjedhojë e kryerjes së një shkelje ligjore të lejuar ose kryer në procesin e s'kualifikimit, nga ana e asaj njësie. Duke patur bindjen se s'kualifikimi për shkak të mungesës së autenticitetit të një pjese të dokumentacionit të paraqitur ishte veprim i drejtë, njësia e burimeve njerëzore ka vijuar procesin e konkurrimit, duke kthyer përgjigje se ankesa e paraqitur nuk mund të pranohet.

Për vlerësimin e ligjshmërisë së qëndrimit të mësipërm të njësisë së burimeve njerëzore, analizohet përmbajtja e pikës 6, të kreut IV, të Vendimit nr. 243, datë 18.03.2015, të Këshillit të Ministrave, *“Për pranimin, lëvizjen paralele, periudhën e provës dhe emërimin në kategorinë ekzekutive”*, në të cilën thuhet: *“Brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e njoftimit individual, në përputhje me pikën 5, të kreut IV, të këtij vendimi, kandidatët që nuk janë kualifikuar kanë të drejtë të paraqesin ankesë me shkrim pranë njësisë përgjegjëse. Ankuesi merr përgjigje brenda 5 (pesë) ditëve kalendarike nga data e depozitimit të ankesës”*.

Nisur nga përmbajtja e dispozitës së mësipërme, vërehet që aty parashikohet e drejta e ankimit të konkurrentit të s'kualifikuar, për veprimin e njësisë përgjegjëse i cili konsiderohet i padrejtë dhe detyrimi për shqyrtimin dhe vlerësimin e atij ankimi brenda një afati 5 ditor, por nuk parashikohet nëse ky shqyrtim do të kufizohet vetëm në vlerësimin e ligjshmërisë së veprimit të njësisë përgjegjëse apo mund të kryhen veprime të tjera plotësuese, nga ana e kësaj të fundit.

Në këto rrethana, qëndrimi i njësisë përgjegjëse të Bashkisë Korçë se në veprimet e kryera prej saj nuk ka shkelje ligjore përderisa s'kualifikimi është vendosur për shkak se dokumentacioni i dorëzuar nga konkurrentja ankuese, brenda afatit të përcaktuar në shpallje, nuk ka qenë i rregullt, nuk mund të konsiderohet i kundraligjshëm.

Për më tepër, konkurrimi për këtë pozicion ka përfunduar dhe pozicioni i lirë është plotësuar me kandidatin që ka patur dokumentacionin e rregullt e që është shpallur fitues.

### Dosja e personelit

Gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucion në lidhje me zbatimin e kërkesave të ligjit për zhvillimin e procedurave të konkurrimit, u konstatua se, dokumentacioni i verifikuar, në këtë rast, administrohet edhe në dosjen individuale të çdo nëpunësi civil.

Të dhënat, të cilat kanë të bëjnë me përvojën në punë, fillimin e marrëdhënieve të punës në pozicionin përkatës (*akti i emërimit*), diplomën e arsimit të lartë që kërkon pozicioni i punës (*nivelin e diplomës dhe fushën e studimeve univeristare*), si dhe plotësimin e kërkesave të

përgjithshme për pranimin në shërbimin civil të përcaktuara në nenin 21, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, janë paraqitur në tabelën nr. 1 dhe nr. 2, bashkëlidhur raportit.

Nga këto të dhëna rezulton se, në institucionin e Bashkisë Korçë, në momentin e mbikëqyrjes janë të punësuar në pozicione të shërbimit civil 107 punonjës, moshë mesatare e nëpunësve është 40 vjeç, ku, 62 punonjës janë gra dhe 45 punonjës janë burra.

Përsa i përket arsimit, konstatohet se, 98 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore publike; 5 nëpunës kanë kryer arsimin e lartë në institucione arsimore private; 4 nëpunës e kanë kryer arsimin e lartë në institucione të arsimit të lartë jashtë vendit. Diplomat janë të njehsuara nga Ministria e Arsimit, i cili është institucioni përgjegjës për njehsimin e diplomave.

Nga verifikimi që u bë për dosjet e personelit, rezulton se ato janë të rregullta, të sistemuara dhe ruhen në kushte të përshtatshme, në ambientet e institucionit dhe administrohen nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Legjislacionit dhe Informimit Publik, që përfaqëson edhe njësinë përgjegjëse për administrimin e burimeve njerëzore për institucionin.

\*

\* \*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Korçë, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësinë përgjegjëse për zbatimin e ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, si dhe të akteve nënligjore, gjatë aplikimit në praktikë të procedurave të pranimit në shërbimin civil dhe zhvillimit të sistemit karrierës nëpërmjet lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë.

Aktet administrative që dokumentojnë procesin e mbikëqyrjes në këtë institucion, sipas pikave të këtij raporti, janë materializuar në tabelat si më poshtë:

- *Tabela nr.1: “Nëpunës të punësuar në pozicione pune, pjesë e shërbimit civil, në momentin e kryerjes së mbikëqyrjes, në Bashkinë Korçë”;*
- *Tabela nr.2: “Respektimi i kërkesave të përgjithshme sipas ligjit dhe i kërkesave të posaçme sipas formularit të përshkrimit të punës, për nëpunësit që në momentin e mbikëqyrjes, janë të emëruar në pozicione të shërbimit civil”.*

Këto ish-in rrethanat e konstatuara gjatë procesit të mbikëqyrjes në institucionin Bashkia Korçë, në lidhje me veprimet administrative të kryera nga njësinë e burimeve njerëzore e institucionit dhe subjektet e tjera të ngarkuara me ligj, si pjesëmarrës në proceset e organizimit të procedurave për plotësimin e pozicioneve të lira në shërbimin civil nëpërmjet pranimit në shërbimin civil, lëvizjes

paralele dhe ngritjes në detyrë për punonjësit e punësuar në institucion në momentin e mbikëqyrjes.

Njësia e burimeve njerëzore e institucionit të mbikëqyrur, duhet të marrë masat për të realizuar detyrat e lëna nga Komisioneri në vendimin e paralajmërimit, brenda afatit të vendosur në vendim, për të rregulluar situatën e administrimit të shërbimit civil në institucion.

**KOMISIONERI**

**Pranvera Strakosha**